



PROGRAMI I "KH SUMMER CAMP" 2024



Përmbledhje
Programit 14 ditor



TË DASHUR PRINDËR!



Ne kemi angazhuar energjitë tona për të ofruar një kamp veror që synon argëtimin dhe edukimin e fëmijëve tuaj përmes një programi, bazuar në filozofinë "Mëso duke bërë", e cila nxit fëmijët të përthithin dhe të kujtojnë më mirë çdo gjë që mësojnë.

Qëllimi ynë kryesor është edukimi nëpërmjet argëtimit dhe lidhja me natyrën.

Detajet e aktiviteteve të përditshme janë planifikuar me kujdes, duke përfshirë tematika të ndryshme ditore të cilat, variojnë nga njohja me kampin dhe ndërtimi i grupit, tek mësimet rreth altruizmit, respektit dhe bashkëpunimit. Fëmijët do të marrin pjesë në lojëra tradicionale dhe moderne, do të eksplorojnë natyrën, do të mësojnë rreth sigurisë rrugore, do të zhvillojnë aftësi të reja përmes veprimtarive të ndryshme si: gjuetia e thesarit, sfilatat e modës me materiale të riciklueshme, dhe madje do të hyjnë në botën e sipërmarrjes. Dita e reflektimit dhe meditimit, si dhe nata e ëndrrave, janë përfshirë për të thelluar përvojën personale dhe emocionale të fëmijëve, duke i ndihmuar ata të lidhin mësimet e ditës me jetën e tyre dhe aspiratat personale.



Klea huta

Founder of KH Summer Camp



AXHENDA E NJË DITE NË KAMP:

08:00	-	09:00	ZGJIMI
09:00	-	09:30	MËNGJESI
10:00	-	11:00	PËRSHËNETJA E MËNGJESIT ME BANSE, LOJËRA, AKTIVITET FIZIK
11:00	-	13:00	PREZANTIMI I TEMËS SË DITËS, DISKUTIMI DHE LOJËRAT SIPAS PROGRAMIT
13:30	-	14:30	DREKA
14:30	-	16:00	KOHË E LIRË
16:00	-	17:00	KLUBET SPORTIVE/ ARTISTIKE & LOJËRAT E LIRA
17:00	-	17:15	VAKTI I ZEMRËS
17:15	-	20:00	KLUBET SPORTIVE/ ARTISTIKE & LOJËRAT E LIRA
20:15	-	21:00	DARKA
21:00	-	22:00	AKTIVITETET SIPAS PROGRAMIT; KINEMA/RRETH ZJARRIT/KARAOKE ETJ...

MIRË SE VJEN NË SHTEPI

DAY

1

Dita e parë fillon me grumbullimin e fëmijëve në qendër të tiranës, dhe nisjen drejt kampit në malin e dajtit ku do të jetojmë dy javët e ardhshme. Pas akomodimit dhe një dreke të shijshme, do të organizohet një shëtitje për tu njohur me mjediset përreth kampit, dhe me hapësirat ku do të zhvillojmë aventurat tona.

Fokusi i kësaj dite do të jetë në dërtimin e grupit dhe aktivitete që synojnë të forcojnë bashkëpunimin dhe të krijojnë një dinamikë pozitive mes kampistëve. Nga lojërat në grupe dhe sfidat, te diskutimet dhe aktivitetet ndërvepruese, kampistët do të mësojnë të njohin njëri-tjetrin dhe të punojnë së bashku për të arritur qëllime të përbashkëta. Këto aktivitete janë krijuar për të rritur aftësitë e komunikimit të tyre, të ndajnë ide dhe të mësojnë rëndësinë e dëgjimit aktiv.

Aktivitetet e para në kamp janë gjithashtu të dizajnuara për të ndihmuar kampistët të njihen me detyrat dhe rolin e tyre brenda grupit. Kjo përvojë fillestare ka si qëllim të vendosë bazat për një bashkëjetesë të këndshme dhe të frytshme në ditët në vijim, duke krijuar një mjedis të sigurt dhe inkurajues për të gjithë.



UNË JAM PJESE E GRUPI



Në një ditë dedikuar të drejtave të njeriut dhe sjelljes në shoqëri në kampin tonë, fëmijët do të mësojnë rreth rëndësisë vitale të respektimit të të drejtave të çdo individi dhe si kjo ndikon në ndërtimin e një komuniteti të shëndetshëm. Ata do të angazhohen në aktivitete dhe diskutime që i nxisin të reflektojnë mbi sjelljet që kontribuojnë në një mjedis të respektueshëm dhe inkurajues për të gjithë. Kjo ditë në kamp është një mundësi për të rritur ndjenjën e solidaritetit dhe të ndihmës ndërmjet kamptistëve, duke i përgatitur ata për të kontribuar pozitivisht në shoqërinë e tyre.



UNË JAM PJESE E GRUPI

SCOUT DAY (EKSPLORIM NË MALIN E DAJTIT)



Kjo ditë do të na zhvendosë nga baza jonë, për tu nisur drejt një eksplorimi emocionues. Një ditë që premtan të jetë një aventurë e vërtetë në zemrën e natyrës. Fëmijët do të kenë mundësinë të zhyten në zbulimin e bukurive natyrore që mali I dajtit ka për t'ofruar. Ata do të studiojnë faunën dhe florën lokale, duke mësuar për bimët dhe kafshët që jetojnë në këtë ambient të mrekullueshëm.

Gjatë këtij eksplorimi, fëmijët do të shoqërohen nga scouts profesionistë të cilët do t'udhëheqin dhe do t'i mësojnë teknika të ndryshme scout, si orientimi me busull, ndërtimi I strehimeve të përkohshme, si dhe rregullat e sigurisë në natyrë. Këto aftësi jo vetëm që do të shtojnë në bagazhin e tyre të njohurive praktike, por do t'i ndihmojnë të zhvillojnë vlera të tilla si pavarësia, bashkëpunimi, respekti për mjedisin dhe vetëbesimi.

Kjo ditë në malin e dajtit nuk është vetëm një mundësi për të mësuar dhe eksploruar, por ne jemi të emocionuar që mund të ofrojmë këtë përvojë unike duke shpresuar që fëmijët të marrin me vete jo vetëm njohuri të reja, por edhe një dashuri të thelluar për mjedisin natyror.



E KA KUSH E KA (LOJËRA TRADICIONALE TË VJETRA)

DAY

4

(Lojëra tradicionale me stafeta, lojëra me uje, qendisje, këngë fëmijësh, këngë të vjetra qytetare, etj..) Një ditë dedikuar tërësisht traditës duke filluar nga lojërat me stafeta, me peta, topa djegësi, litar, hapa dollapa etj.. Për të vijuar me qendisjen e deri tek këngët e vjetra qytetare dhe për fëmijë, të cilat brezat e rinj rrallë i njohin e i dinë.

Duke risjellë lojra nostalgjike dhe formën se si prindërit janë argëtuar dikur, fëmijët do të kuptojnë më shumë nga një kohë të cilën nuk e kanë jetuar, por mbetet forma më e shëndetshme për t'u rritur, zhvilluar dhe kultivuar vlera.

Pa kurrëfarë dallimi, në këtë kamp ndërkombëtar jemi të sigurt se të gjithë fëmijët pjesëmarrës do të njihen njësoj me lojërat tona tradicionale.



E KA KUSH E KA

ME KE MUA



Politikat dhe rregulloret e kampit tonë ndaj bullizmit janë jashtëzakonisht të rrepta, sepse ne e konsiderojmë trajtimin e kësaj çështjeje jo vetëm si një detyrim moral, por si një element kyç për të siguruar një mjedis të sigurt dhe mbështetës për çdo kampist. E trajtojmë çdo vit bullizmin si temë kryesore në kampet tona, pasi fëmijët përballen me këtë sfidë në shkolla, në mjedise virtuale apo edhe në shtëpi, shpesh pa dijeninë se si të mbrohen ose si të raportojnë rastet e bullizmit. Është thelbësore që fëmijët të mësojnë të njohin sjelljet e bullizmit dhe të ndjehen të sigurt të flasin kur e përjetojnë atë ose kur e shohin të ndodhë me të tjerët.

Ne përdorim këtë fokus në bullizim për të krijuar një komunitet ku respekti, përkujdesja dhe empatia janë vlerat që dominojnë, duke i bërë kampistët të ndjehen të vlerësuar dhe të mbrojtur. Duke adresuar këto çështje vit pas viti, ne ndërtojmë një kulturë ku bullizmi nuk është i mirëpritur, dhe ku fëmijët mësojnë të mbrojnë veten dhe të tjerët nga pasojat e tij.



CAMPING RULES.

*BREATHE THE FRESH AIR.
LISTEN TO THE BIRDS.
STARE AT THE FIRE.
WATCH THE SUNSET.
COOK OVER THE FIRE.*

**READ.
RELAX.
TAKE A NAP.**

GJUETIA E THESARIT (XIXO KËRKON NDIHMËN TONË)



Një ditë tjetër e veçantë në kampin tonë është gjuetia e thesarit, një aventurë që fillon me agimin e ditës dhe zgjat deri në perëndimin e diellit. Imagjinoni emocionin që ndjen çdo kampist kur merr hartën e thesarit, shikojnë shenjat dhe fillojnë të zgjidhin misteret e fshehura në çdo cep të kampit. Kjo nuk është vetëm një lojë; është një udhëtim në botën e bashkëpunimit, zgjidhjes së sfidave dhe aventurës.

Ndërsa dita përparon, kampistët, të ndarë në grupe, do të përballen duke përdorur shkathtësitë e tyre mendore dhe fizike për të zgjidhur sfidat dhe për të gjetur thesarin e fshehur. Ata do të duhet të komunikojnë, të bashkëpunojnë dhe të mendojnë kreativisht për të gjetur udhëzimet e ardhshme. Emocionet fluturojnë lart kur çdo grup kalon nga një sfidë në tjetrën, me zemrën plot shpresë për të zbuluar thesarin e fshehur.

Gjatë kësaj gjuetie, kampistët do të përjetojnë një gamë të gjerë emocionesh - nga emocionet e zbulimit të një piste të re, gëzimi i zgjidhjes së një enigme, deri te kënaqësia e arritjes së qëllimit në grup. Këto momente jo vetëm që ndërtojnë kujtime të paharrueshme, por edhe mësojnë vlerën e punës në ekip. Në fund të ditës, kur thesari zbulohet dhe lotët e humbjes dhe buzëqeshjet e fitores mbushin fytyrat e lodhura, të gjithë do të kuptojnë se vlera më e madhe që kanë fituar është përvoja dhe kënaqësia e arritjes së një qëllimi të përbashkët. Kjo ditë e gjuetisë së thesarit në kamp do të mbetet gjatë në kujtesën e tyre.




NA ISHTE NJË HERË (TË MOSHUARIT E AZILIT TË PLEQËVE)



Kjo ditë do të ishte një nga pikat kulmore të kampit tonë, duke l afuar brezat e vjetër dhe të rinj. Do të ishte një moment ku jeta, me të gjithë thelbin, rëndësinë dhe vlerën e saj, do të vendosej në qendër të vëmendjes. Përmes tregimeve të ndjera dhe frymëzuese të brezave më të moshuar, do të krijohen ura të njohurisë dhe frymëzimit për fëmijët, duke iu dhënë atyre mundësinë të dëgjojnë, të pyesin dhe të mësojnë nga përvojat e tyre. Në këtë ditë, fëmijët do të marrin pjesë në lojëra që l përkohjnë kohës së gjyshërve të tyre, ndërsa këta të fundit do të njihen me lojërat e preferuara të brezit të ri. Kjo përzierje e veçantë e aktiviteteve synon të vlerësojë kujtimet e krijuara jashtë botës digjitale dhe të nxisë një ndërveprim të pasur ndërgjeneracional, duke theksuar ndikimin e thellë dhe vlerën e përrjetshme të mësimave që transmetohen nga njëra gjeneratë në tjetrën.




COLOR DAY



Gjysma e parë e kësaj dite në kamp do të jetë shumë e dobishme pasi kampistët do të marrin njohuri kyçe për sigurinë rrugore. Me ndihmën e profesionistëve nga dpshttr, skoda, kryqi I kuq shqiptar dhe policia bashkiake, ata do të mësojnë si të qendrojnë të sigurt në rrugë dhe të kuptojnë rëndësinë e semaforëve, shenjave rrugore, dhe të adoptojnë sjellje të sigurt të gjitha nëpërmjet lojërave dhe informacioneve kreative dhe ilustruese të përshtatura për fëmijët.

Pasdite do të fillojë festivali I ngjyrave "color day" - fëmijët festojnë duke përdorur bojëra të ndryshme për të shprehur lirinë dhe kreativitetin e tyre. Ky mini festival ofron një përzierje të muzikës, artit, dhe kulturës, duke I krijuar kampistëve një atmosferë euforike dhe të gëzueshme.





GOOGLE-O BIZNESIN TIM

DAY



Dita e 9- të e kampit. Fëmijët do të hyjnë në botën e sipërmarrjes duke krijuar bizneset e tyre të imagjinuara. Ata do të përdorin materiale të riciklueshme për të ndërtuar modele të bizneseve të tyre dhe do të përgatisin një plan të thjeshtë biznesi. Gjatë paradites, një sipërmarrës shumë i suksesshëm, do t'u japë këshilla të vlefshme mbi si të bëhen të suksesshëm, sipërmarrësit tanë të vegjël.

Ata do të mësojnë të bashkëpunojnë, të jenë kreativë dhe të marrin vendime të rëndësishme - të gjitha këto në një mënyrë argëtuese dhe miqësore. Kjo përvojë jo vetëm që ndihmon në zhvillimin e aftësive të tyre komunikuese dhe menaxhuese, por gjithashtu i bën ata të ndihen më të sigurt dhe të pavarur.



GOOGLE-O
BIZNESIN TIM

KRIJO DUKE RICIKLUAR (SFILATA E SË ARDHMES)



Në ditën e veçantë të kampit, e quajtur "sfilata e së ardhmes", kampistët ndahen në grupet përkatëse dhe u jepet detyra të përdorin materiale të riciklueshme për të krijuar karaktere, figura, objekte dhe veshje. Ky aktivitet synon të zgjerojë imagjinatën e tyre dhe të promovojë lirinë në shprehje dhe vendimarrje. Gjatë kësaj dite, ata do të punojnë së bashku për të transformuar idetë e tyre në krijime konkrete, duke dhënë formë imagjinatës përmes artit dhe krijimtarisë.

Pasdite, të gjitha grupet marrin pjesë në një sfilatë ku prezantojnë punën e tyre. Kjo sfilatë jo vetëm që është një moment festiv dhe argëtues, por gjithashtu një mundësi për fëmijët të ndiejnë krenarinë për punën e tyre dhe të marrin vlerësime për përpjekjet e tyre krijuese. Kujdestarët e tyre, vendosur në rolin e jurisë, votojnë për krijimet më të bukura, duke dhënë një element të lehtë garues aktivitetit.

Grupi fitues, i cili shpallet në fund të sfilatës, shpërblehet me një darkë speciale në një nga ambientet më të bukura të kampit, duke u dhënë një përvojë të paharrueshme dhe një ndjenjë arritjeje. Ky aktivitet është jo vetëm një mënyrë për të inkurajuar kreativitetin dhe bashkëpunimin mes kampistëve, por gjithashtu një mënyrë për t'i mësuar atyre vlerat e qendrueshmërisë dhe rëndësinë e riciklimit, duke i përgatitur për një të ardhme më të gjelbër dhe më të ndërgjegjshme.




KRIJO DUKE
RICIKLUAR

*WE DIDN'T
REALIZE WE
WERE MAKING
MEMORIES,
WE WERE
JUST HAVING
FUN*
-Winnie the Pooh

PERË VETEN, NGA VETJA, NËPËRMJET VETES

DAY



Ne jemi të përkushtuar të mbështesim rritjen dhe zhvillimin e brezave të rinj, duke u ndihmuar atyre të përfitojnë nga dijet më të reja në fushën e zhvillimit psiko-fizik. Me dashuri, ne sjellim pranë kampionëve, mentorë me reputacion të lartë dhe ekspertizë të vlerësuar nga brenda dhe jashtë vendit, figura të jashtëzakonshme në fushën e tyre.

Gjatë kësaj dite, do të fokusohemi në praktikatat e mirëqenies si meditimi dhe ushqyerja e shëndetshme. Kampionët do të kenë mundësinë të njihen dhe mësojnë nga këta mentorë përmes një komunikimi të ngrohtë dhe të qartë, i dizajnuar për të qenë i kuptueshëm për të gjithë grupmoshat.

Ne jemi të lumtur që sjellim këtë risi në fushën e aktiviteteve argëtuese dhe edukative, duke hapur një kapitull të ri drejt një të ardhmeje ku fëmijët janë më të informuar mbi zhvillimin e tyre personal.





PER VETEN
NGA VETJA
NËPËRMJET VETES

SHPREH NJË DËSHIRË (NATA E ËNDRRAVE)



Gjatë paradites, fëmijët do të kenë një takim të veçantë me ekspertë të internetit. Këta profesionistë do të ofrojnë një sesion të detajuar mbi sigurinë online, dhe mënyrat për të identifikuar dhe evituar rreziqet e ndryshme digjitale. Fëmijët do të mësojnë të krijojnë fjalëkalime të forta, të njohin e të shmangin çdo lloj keqpërdorimi apo ngacmimi në internet.

Pas këtij sesioni të pasur mësimor dhe pas përfundimit të aktiviteteve të organizuara gjatë ditës, mbrëmja do të ofrojë aktivitetin e veçantë, "Shpreh një dëshirë". Ky moment është konceptuar si një kohë për refleksion në formë meditimi, duke u dhënë fëmijëve hapësirën për të shkruar në blloqe kujtimi dëshirat e tyre.



SHPREH NJË
DËSHIRË!

KAMPI IM KA TALENTE



Kjo ditë veçanërisht ndërthur emocionet dhe arritjet, kur kampistët japin performancën përfundimtare, një shfaqje që pasqyron përpjekjet dhe talentet e tyre të brumosura gjatë ditëve në kamp. Ato momente janë fryt i punës së tyre kolektive, një dhuratë për prindërit dhe një kujtim i paharrueshëm për vetë ata.

Provave të performancës u jepet kohë e mjaftueshme, duke u siguruar që çdo detaj të jetë i përpiktë. Dhe në mbrëmje, kur errësira mbulon qiellin, kampistët do të shndrisin në skenë para një audience që përfshin prindërit dhe të afërmit e tyre, duke shfaqur me krenari atë që kanë përgatitur me kaq shumë dashuri dhe përkushtim. Ky moment kulmor shërben si një pikë reflektimi dhe vlerësimi për të gjithë, duke mbyllur kështu një kapitull të rëndësishëm në jetën e tyre në kamp.



MIQ PËRGJITHMONË





Dita e fundit e kampit. Emocionet arrijnë kulmin. Kampistët, të mbushur me ndjesi falenderimi dhe dashurie për momentet e kaluara së bashku, shpenzojnë kohën e tyre të fundit duke shkëmbyer përqafime, ndonjëherë edhe lot, si shenjë e miqësive të vërteta që kanë lindur në kamp.

Fëmijët, edhe pse të emocionuar për rikthimin në shtëpi, ndjejnë gjithashtu një ndjenjë melankolie që po largohen nga kampi dhe nga njerëzit që tani janë bërë pjesë e historive të tyre personale.

Përfundimi i kampit shënon një kapitull të ri për secilin prej nesh, të mbushur me kujtime dhe mësim të reja, si dhe me mirënjohje për çdo qeshje, përqafim dhe mbështetje të ndërsjellë.

Këto momente do të na mungojnë të gjithëve.



MIQ
PËRGJITHMONË



SUMMER CAMP